VENDIM
Nr. 311, datë 9.5.2012

PËR AKORDIM FONDI BASHKISË KUKËS PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME KU JANË VENDOSUR VARREZAT PUBLIKE TË QYTETIT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012" dhe ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkisë Kukës, në buxhetin e vitit 2012, t'i akordohet fondi prej 3 460 000 (tre milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme ku janë vendosur varrezat publike të qytetit të Kukësit.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm dhe bashkia Kukës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha